



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 972/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit New Co Aromatik LL.C., me numër të biznesit 810546822 me adresë rruga “Tirana” p.nr, me seli në Prizren, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson zyra e avokatëve Hodaj & Partners me seli në rrugën “Fehmi Agani” nr.79/8 në Prishtinë, kundër debitorit Telekom i Kosovës Sh.a., me numër të biznesit 70280741, me adresë në lagjen Dardania, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.198/21, të datës 23.04.2021, të Përmbartuesit Privat Rrezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 17.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Telekom i Kosovës SH.A, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.198/21, të datës 23.04.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, me seli në Prishtinë, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NEW CO AROMATIK, LL.C, me seli në Prizren, ka caktuar urdhrin P.nr.198/21, të datës 23.04.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave: Fatura nr.114/18 e datës 01.08.2018, Fatura nr.130/18 e datës 01.09.2018, Fatura nr.179/18 e datës 03.12.2018, Fatura nr.59/19 e datës 01.04.2019,, Fatura nr.154/19 e datës 01.11.2019, Fatura nr 167/19 e datës 02.12.2019, Fatura nr.9/20 e datës 07.01.2020, Fatura nr.22/20 e datës 03.02.2020, Fatura nr.35/20 e datës 04.03.2020, Fatura nr.58/20 e datës 03.05.2020, Fatura nr.70/20 e datës 01.06.2020, Fatura nr.82/20 e datës 01.07.2020, Fatura nr.94/20 e datës 03.08.2020, Fatura nr.106/20 e datës 01.09.2020, Fatura nr.118/20 e datës 01.10.2020, Fatura nr.130/20 e datës 02.11.2020, Fatura nr.142/20 e datës 01.12.2020, Fatura nr.7/21 e datës 05.01.2021, Fatura nr.19/21 e datës

01.02.2021, Fatura nr.31/21 e datës 01.03.2021, Fatura nr.43/21 e datës 05.04.2021, me të cilën e ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 19,923.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e rënies në vonesë të debitorit, deri në përmbushjen definitive të kërkesës, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore përfshirë edhe shpenzimet e avokatit dhe atë sipas tarifës së Odës së Avokatëve në shumën prej 208.00 Euro.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e kundërshton në tërësi urdhrin për përbarim si të pabazuar, duke theksuar se urdhri nuk mund të ekzekutohet dhe nuk është i përbarueshëm sepse dokumentet e bashkangjitura kontrata e qirasë nr.04-4598 e datës 30.11.2017, si dhe kopjet e faturave të lartcekura nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm. Më tutje, debitori në prapësim ka deklaruar se sipas LPP-së, dokumenti përbarues duhet të dorëzohet në origjinal ose kopje të vërtetuar apo të noterizuar, ndërsa në rastin konkret kreditori nuk i ka dorëzuar të njëjtat ashtu siç kërkohet sipas ligjit. Ka shtuar se dokumenti ekzekutiv në bazë të cilit është marrë urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Andaj debitori ka propozuar që të aprovohet prapësimi, dhe të refuzohet propozimi i kreditorit si i pa bazuar. Gjithashtu, ka propozuar që kreditori t'i bart shpenzimet e procedurës përbarimore, në lartësinë që e përcakton përbaruesi privat, përkatësisht gjykata.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se debitori në prapësim nuk ka bashkangjitur prova të cilat argumentojnë pretendimet e tij të parashtruara në prapësim, ndonëse edhe sikur të paraqiteshin nuk do të kishin impakt në një vendim ndryshe. Tutje ka shtuar se pretendimi i debitorit se faturat mbi bazën e të cilave është lëshuar urdhri për përbarim nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm, është i pabazuar. Gjithashtu, kreditori ka theksuar se dokumentet e besueshme-faturat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim janë origjinale dhe të njëjtat i ka pranuar debitori edhe përmes e-mailit, në fund i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, dhe të vërtetohet urdhri përbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën

Përmbardimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbardim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet-faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbardim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmbajnë nënshkrimin e as vulën e pranuesit – debitorit, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar tek debitori pasi që të njëjtat nuk janë të nënshkruara apo të vulosura nga debitori, dhe si të tillë të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk kanë tipare të përmbardueshmërisë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet e besueshme mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit Përmbarduesi Privat ka lejuar përmbardimin, nuk ka tipare të përmbardueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.972/22, datë 17.10.2023

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.